

Termet e Referencës

Ekspert/e për strukturimin e një udhëzuesi për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe prindërit e tyre që të përfshihen në procesin e buxhetimit me pjesëmarrje dhe të ndikojnë në vendimmarrje

I. HYRJE

HANDIKOS, "Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Kosovës" është krijuar si reagim ndaj gjendjes së vështirë në të cilën gjenden personat me aftësi të kufizuara në Kosovë, e themeluar nga dhe për personat me aftësi të kufizuara, me aktivitete të pandërprera që nga viti 1983. Si organizatë përfaqëson, përkrahë dhe punon për dhe me personat me aftësi të kufizuar përmes avokimit dhe lobimit. Ofron shërbime të ndryshme përmes rrjetit të shtrirë në gjithë Kosovën dhe promovon barabarësinë, jetën e pavarur dhe me dinjitet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.

II. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

HANDIKOS në partneritet me Save the Children në Kosovë është duke implementuar projektin "Handikos for Child Rights-H4CR", i cili financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim (SIDA). Përmes këtij projekti HANDIKOS synon ngritjen e kapaciteteve dhe fuqizimin e fëmijëve me Aftësi të Kufizuara.

Grupi Avokues i Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara "Hëna" është grup jo formal i themeluar nga HANDIKOS që nga viti 2017, i cili që nga themelimi ka për mision të garantoj të drejtat e fëmijëve për fëmijët me aftësi të kufizuara. Hëna përfaqëson nevojat e fëmijëve në nivel lokal dhe qendror, për më tepër është aktivisht i përfshirë në të gjitha proceset e HANDIKOS.

III. OBJEKTIVA E DETYRËS

HANDIKOS kërkon të angazhojë një ekspert/e për hartimin e një udhëzuesi praktik që do t'u mundësojë fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe prindërit e tyre të përfshihen në procesin e buxhetimit me pjesëmarrje në nivel lokal.

Ky udhëzues do të ketë për qëllim të strukturojë qartë hapat, metodat dhe mjetet që fëmijët me aftësi të kufizuara dhe prindërit e tyre mund të përdorin për të ndikuar në vendimmarrje dhe për të kërkuar përfshirje efektive në planifikimin dhe ndarjen e buxhetit komunal.

Përmes këtij udhëzuesi synohet:

- Të promovohet përfshirja aktive e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe e prindërit e tyre në hartimin e buxhetit komunal;
- Të ofrohet një qasje e kuptueshme dhe e përshtatshme për moshën dhe aftësitë, mbi funksionimin e buxhetimit pjesëmarrës;
- Të fuqizohen prindërit dhe fëmijët për të identifikuar nevojat dhe prioritetet e komunitetit të tyre dhe t'i adresojnë ato në takime publike/dëgjime buxhetore.

Dardania 4/7 lam.D-2, Prishtinë www.handi-kos.org E-mail: handikos@handi-kos.org, Prishtinë , Kontakt: +383 45/499-677 +38349/970 587

Commented [TH1]: Rekomandoj të potencohet diku edhe roli i avokimit në anagzhimin në pjesëmarrje në proceset buxhetore

- Të potencohet roli i avokimit si një mjet thelbësor për të nxitur pjesëmarrjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe të prindërve të tyre në proceset buxhetore.

IV. KUALIFIKIMI

- Diplomë universitare në shkencë sociale, menaxhim, zhvillim organizativ ose fusha të ngjashme;
- Njohuri dhe ndjeshmëri për çështjet e të drejtave të fëmijëve me theks të veçantë për fëmijët me aftësi të kufizuara ;
- Aftësi të mira analitike dhe të dokumentimit;
- Përvojë të mëparshme për detyra të ngjashme;
- Aftësi të mira komunikimi me fëmijët dhe të rinjtë.

V. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

Hartimi i një udhëzuesi të strukturuar për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe prindërit e tyre, që do të përfshijë:


- Shpjegim të thjeshtësuar të procesit të buxhetimit pjesëmarrës në komunat e Kosovës;
- Metodat për identifikimin e nevojave dhe prioriteteve nga fëmijët dhe prindërit;
- Modelet e pjesëmarrjes në dëgjime publike dhe mënyrat për të kontribuar me propozime;
- Mjete për përgatitjen dhe paraqitjen e kërkesave në gjuhë të kuptueshme;
- Udhëzime për bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet përkatëse;
- **Sugjerime për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kërkesave të pranuar në buxhet;**
- Të sigurojë që udhëzuesi përfshinë praktika të mira dhe shembuj konkretë që lehtësojnë dhe garantojnë pjesëmarrje cilësore të fëmijëve me aftësi të kufizuara në proceset e buxhetimit pjesëmarrës, duke u bazuar në parime të aksesueshmërisë, gjithëpërfshirjes dhe fuqizimit të tyre si vendimmarrës aktivë;
- Sigurimi që përmbajtja e udhëzuesit është në përputhje me Udhëzimin Administrativ MAPL NR.04/2023 për buxhetimin pjesëmarrës;
- [Të sigurojë pjesëmarrjen sipas:](#)
[Nine Basic Requirements for Meaningful and Ethical Child Participation](#)

Commented [TH2]: Rekomandoj të shtohet edhe ndonjë detyrë e cila specifikon dobine e udhëzuesit në venien e praktikave të mira që lehtësojnë pjesëmarrjen dhe e sigurojnë atë cilësore të fëmijëve me aftësi të kufizuara

VI. ANGAZHIMI I ESKPERTIT/ES

Eksperti/ja do të angazhohet me anë të një kontrate për shërbim me HANDIKOS. Angazhimi do të bëhet gjatë muajit Korrik 2025 në bazë ditore, ku do të përfshihen aktivitetet e mëposhtme:

Detyra	Kohëzgjatja
Angazhimi i ekspertit/es për hartimin e manualit	7 ditë



VII. KUSHTET E PAGESËS

Pagesa e ekspertit/es do të bëhet sipas faturës përkatëse për kryerjen e shërbimeve, që do të leshohet nga ai/ajo. Pagesa do të bëhet pas përfundimit dhe dorëzimit të dokumentit final të aprovuar nga HANDIKOS.

HANDIKOS do të realizoj pagesën në Euro, shuma bruto për ditët e punës (nga të cilat do të ndalet tatimi në fitim dhe kontributi pensional sipas ligjeve në fuqi në Kosovë).

HANDIKOS rezervon të drejtën e negociimit të propozimit financiar.

VIII. PROCEDURA PËR APLIKIM

- Metodologjia e punës për këtë angazhim, përfshirë planifikimin e mbajtjes së punëtorisë dhe hartimin e planit të punës (max. 3 faqe);
- Curriculum Vitae (CV) (max.3 faqe);
- Propozimi financiar

Aplikacionet duhet të dorëzohen në formë elektronike në e-mail adresën: handikos@handi-kos.org
cc: nora.simitciu@handi-kos.org dhe antika.maksutaj@handi-kos.org

Ju lutem, shkruani në subjekt Aplikimi për "Ekspert për hartimin e dokumentit të buxhetimit me pjesëmarrje"

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është 6 Korrik, ora 17:00.

Vetëm kandidatët e suksesshëm do të kontaktohen!

Pas përzgjedhjes Eksperti/ja i përzgjedhur duhet të dërgojë:

- **Dokumentin/ Dëshminë që nuk jeni nën hetime.**
- Poashtu duhet të nënshkruaj **Politikën për Mbrojtjen e Fëmijëve** si dhe **Rregulloren mbi Parandalimin e Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual — PSHAS** dhe t'u përmbahen kushteve dhe kritereve të tyre.